

PAULO COELHO

MALI I PESTĚ

ROMAN

BOTIMET TOENA

*Libra të Paulo Coelho-s, në shqip
nga Shtëpia Botuese TOENA*

- * Alkimisti
- * Mali i pestë
- * Veronika vendos të vdesë
- * Djalli dhe zonjusha Pym
- * Pelegrini i Kompostelës
- * Manuali i luftëtarit të dritës
 - * Njëmbëdhjetë minuta
 - * Zahiri
- * Shtriga e Portobelos
- * Buzë lumit Piedra u ula dhe qava
 - * Fitimtari është i vetëm
 - * Brida
 - * Alef
- * Shkelja e kurorës
- * Dorëshkrimi i gjetur në Akra
 - * Spiunia
 - * Hipi
- * Shigjetari
- * Maktub

PAULO COELHO

MALI I PESTË

roman

Përktheu Nonda Varfi

ribotim

BOTIMET TOENA

Titulli në origjinal: O Monte Cinco

*Ky libër u botua sipas marrëveshjes me Sant Jordi
Asociados Agencia Literaria S.L.U., Barcelona-Spain.
www.santjordi-asociados.com
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.*

Botuese: Irena Toçi

Korrektor letrar: Adem Jakllari

Përkujdesja grafike: Gea Qëndro

© i kopertinës: Jim Tierney, në bashkëpunim me
HarperCollins, me bazë në Nju-Jork, SHBA.

ISBN 9789928960597

© PAULO COELHO, 1996

<http://paulocoelhoblog.com>

© në shqip BOTIMET TOENA

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet
shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me
fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", nr. 71, Tiranë 1023

ose K. Postare 1420

Tel.: +355 67 70 70 884

botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

Për A.M., luftëtarin e dritës

Shënimi i autorit

Teza qendrore e romanit tim *Alkimisti* mbështetet në një frazë që mbreti Melshizedek i drejton bariut Santiago: “Kur ti dëshiron diçka, i gjithë universi konspiron që të të lejojë ta përmbushësh dëshirën.”

Unë besoj plotësisht në këtë pohim. Megjithatë, akti i të jetuarit të fatit përmban një varg etapash, shumë ndryshe nga sa kuptojmë, dhe ka si pikësynim të na shpjerë papushim në rrugën e Legjendës Vetjake – ose të na japë mësimet e duhura për përmbushjen e këtij fati. Më duket se do t’i ilustroja më mirë këto fjalë duke rrëfyer një episod nga jeta ime.

Më 12 gusht 1979, po shkoja të kumbisesha me një siguri të vetme: në moshën tridhjetë vjeçare, po arrija kulmin e karrierës si prodhues disqesh. Si drejtor artistik i CBS në Brazil, kisha marrë një ftesë për në Shtetet e Bashkuara për të takuar

pronarët e shtëpisë së disqeve dhe, padyshim, ata do të më ofronin kushtet më të mira për të përmbushur dëshirat në atë fushë. Sigurisht, ëndrra ime e madhe – të bëhesha shkrimtar – ishte lënë mënjanë, por ç'rëndësi ka? Në fund të fundit, jeta reale ishte krejt ndryshe nga sa e kisha imagjinuar; në Brazil nuk kishte asnjë hapësirë për të jetuar me letërsi.

Atë natë, mora një vendim dhe e braktisa ëndrrën: duhej të përshtatesha me rrethanat dhe të mos i lija rastet të më shpëtonin nga duart. Po të pezmatohesha zemra, gjithnjë mund ta gënjeja duke shkruar tekste këngësh sa herë të doja dhe, herë pas here, duke firmosur ndonjë shkrim në një gazetë. Për çka mbetej, isha i bindur se jeta kishte marrë një drejtim tjetër, jo më pak ngasës: më priste një e ardhme e ndritur në shoqëritë shumëkombëshe të muzikës.

Kur u zgjova, më telefoni presidenti: më falënderonte pa më dhënë asnjë shpjegim. Nuk lashë portë pa trokitur gjatë dy vjetëve që pasuan. Nuk gjeta kurrë punë në atë fushë.

Kur po mbaroja redaktimin e *Malit të Pestë*, m'u kujtua ky episod – dhe shfaqje të tjera të

së pashmangshmes në jetën time. Sa herë që ndihesha plotësisht zot i situatës, ndodhte ndonjë ngjarje dhe më bënte të dështoja. Pyeta vete përse. Mos vallë isha i dënuar t'i afrohesha gjithnjë pikëmbrritjes pa e arritur kurrë? Mos vallë Zoti ishte aq mizor sa të më tregonte palmat në horizont dhe të më linte të vdisja nga etja në mes të shkretëtirës?

Shumë vonë e mora vesh se arsyeja ishte krejt ndryshe. Disa gjasa janë kallur në jetën tonë për të na shpënë drejt rrugës së vërtetë të Legjendës Vetjake. Të tjera ngrenë krye për të na lejuar ushtrimin e njohurive tona. Së fundi, disa prej tyre ndodhin për të na mësuar diçka.

Te *Pelegrini i Kompostelës*, jam rrekur të dëftej se këto mësimë nuk janë domosdoshmërisht të lidhura me dhimbjen dhe vuajtjen; disiplina dhe kujdesi mjaftojnë. Edhe pse kjo bindje që bërë një bekim i rëndësishëm në jetën time, megjithë disiplinën dhe kujdesin tim, nuk kam mundur të kuptoj disa çaste të vështira, nëpër të cilat kam shkuar.

Anekdotat, që tregova, është një shembull: isha një profesionist i mirë, përpiqesha të jepja çka

më të mirë kisha në vete, dhe kisha ide që ende sot i quaj të mira. Por u shfaq e pashmangshmja pikërisht në çastin kur ndihesha më i sigurt dhe më besëplotë. Mendoj se kjo përvojë nuk është e vetme: e pashmangshmja ka goditur jetën e të gjitha qenieve njerëzore mbi faqen e dheut. Disa e kanë marrë veten, të tjerat e kanë lëshuar – por ne të tërë jemi prekur rrëshqanthi nga krahu i tragjedisë.

Pse? Për t'i dhënë një përgjigje kësaj pyetjeje, kam lënë Elian të më prijë ditëve dhe netëve të Akbarit.

Paulo COELHO

“Dhe shtoi: “Në të vërtetë po ju them se asnjë profet nuk mirëpritet në atdheun e vet. Në të vërtetë, po ju them se në kohën e Elias, kur qielli u mbyll për tre vjet e gjashtë muaj dhe ra një zi e madhe buke në të gjithë vendin, kishte shumë të veja në Izrael; e megjithatë tek asnjëra nuk u dërgua Elia, përveçse te një grua e ve në Sarepta të Sidonit”

Luka. 4.24-26

Prolog

Në fillim të vitit 870 para Jezu Krishtit, një komb i njohur me emrin Fenici, që izraelitët e quanin Liban, festonte, pothuaj tre shekuj paqe. Banorët e tij kishin arsye të mburreshin. Meqenëse nuk ishin shumë të fortë në lëmin politik, ishin detyruar të bënin marrëveshje lakmitare, mjete i vetëm për të mbijetuar në një botë të rrënuar vazhdimisht nga luftërat. Marrëveshja e lidhur rreth vitit 1000 para Jezu Krishtit me Salomonin, mbretin e Izraelit, kishte nxitur modernizimin e flotës tregtare dhe shtrirjen e tregtisë. Që prej atëherë, zhvillimi i Fenicisë nuk kishte rreshtur.

Detarët e saj kishin shkuar në vise të largëta, si Spanja dhe brigjet që lageshin nga Adriatiku. Sipas disa teorive - që nuk janë vërtetuar -, ata duhet të kenë lënë mbishkrime në Nordeste dhe në jug të Brazilit. Ata bënin tregtinë e xhamit, të drurit të cedrës, të armëve, të hekurit dhe të fildishit. Banorët e qendrave të mëdha të Sidonit,

Tyrit dhe Biblos njihnin numrat, përlllogaritjet astronomike, verën dhe përdornin, që prej dyqind vjetësh, një tërësi shkronjash për të shkruar, që grekët e quanin alfabet.

Në fillim të vitit 870 para Jezu Krishtit, një këshill lufte u mbledh në qytetin e largët të Ninivës. Një grup gjeneralësh asirianë kishin vendosur, në fakt, të dërgonin trupat për të pushtuar kombet në brigjet e Mesdheut dhe, piksëpari, Fenicinë. Në fillim të vitit 870 para Jezu Krishtit, dy burra të fshehur në një stallë të Gaaladit në Izrael, prisnin vdekjen nga çasti në çast.

PJESA E PARË

“**I**kam shërbyer një zoti që tani më braktis në duart e armiqve të mi, tha Elia.

- Zoti është Zot, u përgjigj leviti. Moisiut nuk ia shpjegoi në ishte i mirë apo i keq, i tha vetëm: *jam*. Ai është gjithçka që ekziston nën diell - rrufeja që shkatërron shtëpinë dhe dora e njeriut që e rindërton”.

Biseda ishte vetëm mënyrë për të larguar frikën. Nga çasti në çast, ushtarët do të hapnin derën e stallës, do t'i zbulonin dhe do t'u propozonin një zgjidhje të mundshme: të adhuronin Baalin, zotin e Fenikasve ose të ekzekutoheshin. Ata kërkonin shtëpi më shtëpi, i detyronin profetët ose të ndërronin fe ose të vdisnin.

Leviti ndoshta do ndërronte fe për të shpëtuar nga vdekja. Por Elia nuk mund të zgjidhte; fajin e

kishte vetë, dhe Jezabela kërkonte me çdo kusht kokën e tij.

“Një ëngjëll i Zotit më dërgoi të bisedoja me mbretin Ashab, ta paralajmëroja se nuk do të binte shi për sa kohë që në Izrael do të adhurohej Baali” – shpjegoi ai, duke kërkuar pothuajse ndjesë që kishte dëgjuar fjalët e ëngjëllit. “Por Zoti vepron ngadalë; kur të duken pasojat e thatësirës, princesha Jezabel do t’i ketë shkatërruar të gjithë besimtarët e Zotit.”

Leviti qëndroi i heshtur. Pyeti veten në duhej të merrte fenë e Baalit apo të vdiste në emër të Zotit.

“Kush është Zoti? - vazhdoi Elia. Mos është ai që mban shpatën e ushtarit dhe vret besimtarët e fesë së patriarkëve tanë? Mos është ai që ka vendosur në fronin e vendit tonë një princeshë të huaj, që mbi brezin tonë të bien gjithë këto fatkeqësi? Mos vallë është Zoti që vret besimtarët, të pafajshmit, ata që ndjekin ligjin e Moisiut?”

Leviti mori një vendim: parapëlqente të vdiste. Atëherë nisi të qeshë, sepse ideja e vdekjes nuk e trembte më. U kthye nga profeti i ri dhe u përpoq ta qetësonte: “Pyete Zotin se kush është, meqënëse

dyshon në vendimet e tij. Sa për mua, e kam pranuar tashmë fatin.

- Zoti nuk mund të urojë që ne të masakrohemi pa mëshirë, këmbënguli Elia.

- Zoti i bën të gjitha. Po të bënte vetëm ato që ne i quajmë të mira, nuk mund ta quanim të Plotfuqishëm. Ai do të zotëronte vetëm një pjesë të gjithësisë dhe do të qe dikush tjetër më i fuqishëm, që të mbikqyrte dhe gjykonte veprimet e tij. Në këtë rast, do të adhuroja këtë më të fuqishmin.

- Nëse i bën të gjitha, përse nuk ua heq vuajtjet atyre që e duan? Përse nuk na shpëton, por u jep lavdi e pushtet armiqve të tij?

- Nuk e di, u përgjigj leviti. Por ka një arsye, dhe shpresoj ta marr vesh së shpejti.

- Nuk i jep dot përgjigje kësaj pyetjeje?

- Jo.”

Të dy qëndruan të heshtur. Elia u mbush me djersë të ftohta. “Ke frikë, ndërsa unë e kam pranuar fatin, vazhdoi leviti. Do dal e do i jap fund këtij makthi. Sa herë që dëgjoj një klithmë atje jashtë, vuaj kur marr me mend se çfarë do të ndodhë kur të bjerë ora ime. Që kur jemi mbyllur

këtu, kam vdekur me qindra herë, kur mund të vdisja vetëm një herë. Le të ma presin qafën, sa më shpejt që të jetë e mundur.”

Kishte të drejtë. Elia kishte dëgjuar të njëjtat klithma dhe kishte vuajtur tashmë matanë durimit.

“Po të shoqëroj. Jam lodhur së luftuari për disa orë më tepër jetë.”

U ngrit, hapi derën e stallës, duke e lënë dritën e diellit të zbulonte praninë e dy burrave të fshehur brenda.

* * *

Leviti e zuri për krahu dhe u nisën për udhë. Përveç disa klithmave, mund të thuhej se ishte një ditë e zakonshme në një qytet çfarëdo - diell jo shumë përvëlues, temperetarurë e këndshme nga puhia e oqeanit të largët, rrugë të pluhurosura, shtëpi të stisura me qerpiç.

“Në këtë ditë të bukur shpirtrat tanë janë robër të tmerrit nga vdekja, tha leviti. Shpesh, kur ndiehesha në paqe me Zotin dhe me njerëzit, vapa ishte e padurueshme, era e shkretëtirës m'i